



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 13, datë 27.08.2025

PËR

**MIRATIMIN E DISA TARIFAVE/PAGESAVE ADMINISTRATIVE PËR SHËRBIMET
QË KRYHEN NGA AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE
POSTARE**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Kledja Cikopano në mbledhjen e datës 27.08.2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1, neni 17, pika 1, shkronja “b” neni 18, neni 27 dhe neni 33 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ligj nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015)

K Ë SHILL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
2. Relacioni shoqërues i Projektvendimit;
3. Komentet e palëve të interesuara të paraqitura gjatë Këshillimit Publik
4. Dokumenti “*Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – Dokumenti përfundimtar*”

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me vendim nr. 02, datë 19.03.2025, ka miratuar për Këshillim Publik dokumentin “*Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare*”.
2. Dokumenti “*Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare-Dokumenti për këshillim publik*” u miratua nga AKEP duke u bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008. Dokumenti për këshillim publik, përmbante propozimin e AKEP për vendosjen e disa tarifave/pagesave administrative që sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet të paguajnë për shërbimet që do kryhen nga AKEP në kuadër të implementimit të regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm (në vijim, AP) sipas ligjit nr.54/2024. Dokumenti dhe propozimet e AKEP u bazuan ndër të tjera në:
 - përcaktimet e Kreut III të ligjit nr. 54/2024, të cilat përmbajnë disa ndryshime të rëndësishme për regjimin e autorizimit të përgjithshëm, të cilat do të reflektohen nga AKEP në Rregulloren përkatëse për AP sipas pikës 8 të nenit 27, që do të jetë objekt i një procesi të veçantë këshillimi publik me palët e interesuara.
 - përcaktimet e reja në nenet 17 dhe 18 të ligjit nr. 54/2024 në lidhje me buxhetin dhe financimin e AKEP si dhe parimet për pagesat administrative/tarifat që paguajnë sipërmarrësit për të mbuluar kostot administrative të AKEP për të kryer funksionet e tij rregullatore, mbikëqyrëse si dhe punën rregullatore për përgatitjen dhe zbatimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.
3. Dokumenti “*Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare-Dokumenti për këshillim publik*” u publikua në faqen e internetit të AKEP-it më datë 26.03.2025 dhe periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 26.04.2025.

4. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, palët e interesuara depozituan në AKEP, komentet si më poshtë:
- Sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” sh.p.k., me shkresën nr. 143 prot, datë 24.04.2025 (protokolluar në AKEP me nr. 732 prot., datë 25.04.2025);
 - Sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., me shkresën me referencë LEA/029/L.R/E.K, datë 22.04.2025 (protokolluar në AKEP me nr. 732/1 prot, datë 28.04.2025);
 - Sipërmarrësi “One Albania” sh.a., me shkresën nr. 979 prot., datë 25.04.2025 (protokolluar në AKEP me nr.732/2 prot, datë 28.04.2025);
 - Sipërmarrësi Albanian Satellite Communication sh.a., në rrugë elektronike me email më datë 28.04.2025;
5. AKEP, pas marrjes dhe vlerësimit të komenteve të palëve të interesuara për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, ka përgatitur dokumentin “*Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – Dokumenti përfundimtar*”.
6. Dokumenti i AKEP “*Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – Dokumenti përfundimtar*”:
- përmban qëndrimin e AKEP mbi komentet dhe sugjerimet e palëve të interesuara të dhëna gjatë procesit të këshillimit publik;
 - ka marrë parasysh tarifa/pagesa administrative të aplikuara për sistemin e autorizimit të përgjithshëm për komunikimet elektronike në vende të BE-së;
 - përmban arsyetimin e AKEP në lidhje me përcaktimin e disa tarifave/pagesave administrative të aplikueshme për sistemin e ri të AP sipas ligjit nr. 54/2024;
 - nga pikëpamja e ligjshmërisë është konform me përcaktimet ligjore të neneve 17, 18, 27 dhe 33 të ligjit nr. 54/2024;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikat 1 të nenit 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin “*Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – Dokumenti përfundimtar*”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të miratojë tarifat/pagesat administrative sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur.
3. Ky vendim dhe dokumenti “*Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – Dokumenti përfundimtar*”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.

4. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet nga momenti i miratimit të Rregullores së re të Autorizimit të Përgjithshëm.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka

ANEKSI 1

Tarifa/pagesa administrative për shërbime të AKEP për Regjistrin e Autorizimit të Përgjithshëm (AP)

Nr.	Shërbimi i AKEP	Përshkrim	Tarifa
1.	Lëshimi i Certifikatës së Konfirmimit të Njoftimit/Regjistrimit (CKNJ)	CKNJ lëshohet për cdo sipërmarrës pas njoftimit dhe regjistrimit në Regjistrin e AP, sipas pikës 5 të nenit 27 të ligjit 54/2024. Tarifa aplikohet vetëm një herë për regjistrimin e parë të sipërmarrësit në Regjistrin e ri të AP.	50.000 Lekë
2.	Lëshimi i Deklaratës/Certifikatës së Konfirmimit për lehtësimin e ushtrimit të të drejtave për instalimin e faciliteteve dhe interkoneksion	Deklarata/Certifikata lëshohet me kërkesë të sipërmarrësit, sipas pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr. 54/2024.	50.000 Lekë
3.	Lëshimi i Certifikatës së Konfirmimit të Ndryshimeve të të dhënave autorizim/CKNJ	Certifikata lëshohet në rastet e njoftimit nga sipërmarrësi të ndryshimeve të ndodhura në informacionin e dhënë fillestar ose atë pararendës, në CKNJ që AKEP lëshon për konfirmimin e regjistrimit të njoftimit mbi ndryshimin e ndodhur (sipas përcaktimeve në Rregulloren e AP)	20.000 Lekë